**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike**

Datë 02.07.2025

# RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit)*: **PËR DHËNIEN E MIRATIMIT TË NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS BASHKISË DURRËS DHE SPITALLA SOLAR SHPK ME QËLLIM TRANSFERIMIN E TË DREJTËS SË PËRDORIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, KËSAJ SHOQERIE NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË PARKUT FOTOVOLATIK TË SPITALLËS ME NJË KAPACITET PREJ 100 MEGAVAT ENERGJI**

**Baza ligjore:**

Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligji Nr. 24/2017, "Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit", VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te Bashkitë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit", ligji nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 906, datë 18.11.2020 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të pronës shtetërore me numra pasurie 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, në zonën Ish-Kënetës, Spitallë ndryshuar me VKM- në 478, datë 13.07.2022 është përcaktuar sipërfaqja e zonës teknologjike dhe zhvillimit ekonomik të shpallur me VKM-në nr. 262, datë 06.04.2016 "Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës".

**Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër** *(Çfarë propozohet në projektvendim):*

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe Drejtoria e Shërbimeve, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë të konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Durrës dhe Shoqërisë "Spitalla Solar" Shpk me objekt transferimin e së drejtës të përdorimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të ndodhura brenda vendndodhjes sipas hartës bashkëngjitur këtij projektvendimi.

**Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):**

-

**Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:**

Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe Drejtoria e Shërbimeve.

**Impakti social/grupet që preken:**

Banoret e zonës Ish-Kënetës, Spitallë.

**A është objekt konsultimi:** *(PO/JO)*

*Jo. Pasi i pwrket pikws e-1 të ligjt 139/2015.*

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, u mblodhë më datë 02.07.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 4 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Kryetarja e komisionit hapi mbledhjen e komisionit. Pyeti anëtarët nëse ka pyetje apo diskutime rreth pikës 4 të rendit të ditës. Anëtarët e komisionit janë dakort me pikën 4 dhe të kalojë në këshill për votim.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:**

a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
b- Miratimin e projekt aktit
c- Refuzimin e miratimit të projektaktit

d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:

e- ______________________________

**Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Kryetar | Marsida Feshti |
| 2 | Zv/Kryetar | Sami Osmani |
| 3 | Sekretar | Joniada Musaraj |
| 4 | Anëtar | Dorian Isaj |
| 5 | Anëtar | Elisabeta Mataj |
| 6 | Anëtar | Flutura Kasa |
| 7 | Anëtar | Edlira Shemsi |
| 8 | Anëtar | Kontjana Kuçi |
| 9 | Anëtar | Erald Dalipi |